



# iSIGURT.al

**PLATFORMA KOMBËTARE PËR SIGURINË NË INTERNET**  
**Linja Kombëtare për Internet në Sigurt për Fëmijët**

## SI TË JEMI TË SIGURT NË INTERNET?

SESION INFORMUES NGA PLATFORMA KOMBËTARE E INTERNETIT TË SIGURT - ISIGURT.al

Punoi: Stafi ISIGURT.al

## Linja Kombëtare për Internet të Sigurt për Fëmijët <sup>2</sup>



- **ISIGURT.al** ka si qëllim të fuqizojë fëmijët, prindërit, mësuesit dhe të gjithë qytetarët që të përdorin internetin dhe mënyrat e tjera të komunikimit teknologjik pozitivisht, të sigurtë dhe në mënyrë efektive; synon të nxisë raportimin e faqeve të paligjshme dhe përmbajtjet e padëshiruara; të bashkërendojë përpjekjet për të identifikuar dhe për të mbrojtur fëmijët viktimë, për të identifikuar materialet e paligjshme dhe ato me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët në internet, për të informuar prindërit mësuesit, fëmijët etj, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional dhe atë me industrinë e internetit.
- Nëpërmjet formës **RAPORTO** në **ISIGURT.al** në web dhe aplikacionit për smartphone, çdokush mund të raportojë në kohën më të shpejtë raste të dhunës dhe abuzimit online, të materialeve të paligjshme etj.



# iSIGURT.al

PLATFORMA KOMBËTARE PËR SIGURINË NË INTERNET  
Linja Kombëtare për Internet në Sigurt për Fëmijët  
NATIONAL PLATFORM FOR INTERNET SAFETY ALBANIA  
National Helpline for Child Internet Safety

# RAPORTO

FOTO E VIDEO SEKSUALE  
TË FËMIJËVE, DHUNË,  
NGACMIME, BULIZËM  
APO KËRCËNIME NË  
INTERNET

# RAPORTO

GJUHË APO  
KRIME  
URREJTJE  
NË INTERNET

•Nëpërmjet formës **RAPORTO** në **iSIGURT.al** në ëeb dhe aplikacionit për smartphone, çdokush mund të raportoje në kohën më të shpejtë raste të dhunës dhe abuzimit online, të materialeve të paligjshme, gjuhën e urrejtjes etj.

# CILI ËSHTE INFORMACIONI QË DUHET RAPORTUAR?

Çfarë përmbatje të papërshtatshme po raportoni?

Ku e keni ndeshur këtë problem?

Adresa e URL të faqes apo profilit

Përshkruaj incidentin që ka ndodhur.

Të dhëna të tjera dhe kontakti

# ÇFARË NDODH PAS RAPORTIMIT?

Një analist vlerëson ankesën dhe incidentin

Nëse mungon informacioni, kontaktohet për të dhëna shtesë

Nëse informacioni është i plotë dhe vërtetohet incidenti analisti kontakton me kompaninë

Kompanisë i rekomandohet marrja e masave (mbyllje e faqes, mbyllje profili, etj.)

Pas marrjes së masës, kontaktohet personi dhe njoftohet për zgjidhjen

INTERNATIONAL ASSOCIATION OF INTERNET HOTLINES

**INHOPE**

## PARTNERITETE STRATEGJIKE TË ISIGURT.AL <sup>6</sup>

- ISIGURT është anëtarësuar dhe është tashmë partner i besuar pranë INHOPE: Shoqata Ndërkombëtare e Linjave të Internetit të Sigurt;
- ISIGURT.AL ka partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë:



Google



# ÇFARË ËSHTE SIGURIA NË INTERNET?

## Disa mënyra për të patur siguri në internet:

- Duhet të keni gjithmonë masa të caktuara mbrojtëse në kompjuterin tuaj në mënyrë që të mbroni veten nga sulmet e mundshme kibernetike dhe kërcënimet ndaj sigurisë tuaj të internetit. Kjo do të thotë se do të ishte mirë të kishim një firewall specifik si dhe një program antivirus që do të jetë gjithmonë i ndezur. Gjithashtu, është e nevojshme të mbroni rrjetin wi-Fi përmes të cilit jeni lidhur në mënyrë që askush të mos mund të “lidhet” me të dhe kjo bëhet më së miri duke vendosur një fjalëkalim të mirë.
- Duke qenë se secili prej nesh që është në internet ka adresën e tij të postës elektronike përmes së cilës komunikon me persona të tjerë, është e nevojshme të kemi kujdes kur hapim mesazhe në kutinë tonë postare. Në veçanti, është e nevojshme t’i kushtoni vëmendje të ashtuquajturave email phishing që synojnë t’ju “nxjerrë” të dhënat tuaja personale në mënyrë që ata t’i keqpërdorin ato. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të shikojmë nga kush marrim e-mail dhe të fshijmë menjëherë çdo e-mail të dyshimtë.
- shënim i rëndësishëm është fokusi për të shkuar vetëm në faqet e verifikuara, sepse në këtë mënyrë do të kuptojmë se jemi plotësisht të sigurt për linkun/faqen që jemi duke hapur.

# DITA E INTERNETIT TË SIGURT

Dita e Internetit të Sigurt (SID) organizohet çdo vit në muajin shkurt për të promovuar përdorimin e sigurt dhe pozitiv të teknologjisë dixhitale, veçanërisht midis fëmijëve dhe të rinjve. Në Shqipëri, dita organizohet nga Platforma Kombëtare për Internet në Sigurt ([www.iSIGURT.al](http://www.iSIGURT.al)), anëtare e INHOPE dhe Insafe, organizatorë të ditës në nivel Europian dhe global. Në të gjithë botën, miliona njerëz bëhen së bashku për të sjellë ndryshime pozitive në internet dhe për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë. Edhe ju mund të luani rolin tuaj në këtë drejtim!



# DISA NGA FORMAT E DHUNËS NË INTERNET

## **Cyber-bulling**

Ky është një term i përdorur për të përcaktuar format e ndryshme të abuzimit psikologjik gjatë aktivitetit online të fëmijëve. Cyber bullying është terminologji që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar, apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe, fotografi dhe video.

## **Shtytja e fëmijëve në marrëdhënie seksuale (Grooming)**

Është përgatitja dhe manipulimi psikologjik i një fëmijë me qëllim shfrytëzimin seksual. Hapi i parë që bën një groomer (abuzuesi) është fitimi i besimit të fëmijës me qëllim paraqitjen veprimeve të tij si të dobishme për vetë fëmijën. Kjo mund të ndodhë në kontekstin e komunikimit privat nëpërmjet programeve të komunikimit (messenger, dhoma chati etj), por mund të ndodhë dhe në rrjetet sociale.

Një groomer (abuzues) mund të manipulojë të dhënat e tij në rrjetet sociale për të krijuar më lehtë marrëdhëniet me fëmijët. Qëllimi i këtyre veprimeve i një groomeri është që të rregullojë një takim me fëmijën ose ta manipulojë atë me qëllim përdorimin e tij për pornografi etj.

## **Pornografia e fëmijëve në internet**

Pedofilia në internet është ngushtësisht e lidhur me pornografinë e fëmijës, e cila është një ndër format më të rrezikshme të dhunës dhe ekspozimit seksual të fëmijës. Pornografia e fëmijës përfshin mbajtjen, prodhimin, botimin, shpërndarjen e imazheve dhe videove, me çdo mjet apo formë, të fëmijës që është duke u angazhuar në një marrëdhënie seksuale, erotike apo në një moment intim, jo detyrësisht me një të rritur, por që qëllimi final është shfrytëzimi i fëmijëve për kënaqësinë seksuale të të rriturve.

# DISA NGA FORMAT E DHUNËS NË INTERNET

## **Sexting (Dërgimi i mesazheve me natyrë seksuale)**

Është një term i përdorur për të përshkruar dërgimin e mesazheve, fotove me përmbajtje erotike dhe seksuale kryesisht nëpërmjet celularëve. Ndonëse dërgimi i këtyre përmbajtjeve mund të jetë e dakordësuar ndërmjet njëri-tjetrit, mund të ndodhë që këto përmbajtje të përfundojnë duke qarkulluar në internet, kryesisht kur marrëdhëniet marrin fund. Edhe pse në shumicën e rasteve nis si një lojë mes adoleshentëve, shpërndarësi i materialeve e humbet kontrollin mbi imazhet dhe shkakton ndjesi turpi tek viktimat, të cilat mund të jenë potencialisht shkatërruese.

## **Hacking (hakërimi)**

Akti i anashkalimit dhe thyerjes të sigurisë në një vendndodhje të autorizuar (një rrjet, kompjuter, skedar, etj.), zakonisht me qëllim keqdashës.

## **Dhuna Online / Dhuna kibernetike**

Përdorimi i sistemit kompjuterik me qëllim shkaktimin e dhunës fizike, seksuale, psiko-sociale apo ekonomike kundrejt individëve të ndryshëm çon në dhunë kibernetike apo ndryshe në dhunë online. Të tillë persona shkaktojnë dëm dhe vuajtje duke marrë parasysh dhe rrethat apo karakteristikat e personave vulnerabël.

## **Detyrim seksual dhe zvatje në internet**

Shpërndarja online ose përmes teknologjive digitale e imazheve dhe informacioneve seksuale si një mjet detyrimi. Qëllimi mund të jetë të shkaktohet e shqetësimi tek viktimat, për përfitime financiare, për abuzim seksual apo për të shfrytëzuar.

***Si mund të  
mbrohemi nga  
incidentet online?***

•Përpquni të respektoni kufizimet e moshës. Faqet që thonë "a i ke mbushur 18 vjeç" e kanë një shkak se pse janë të ndaluara për nën 18 vjeçarët. Besojini! Mos hyni!

•Kuptoni që jo çdo informacion që mund të gjendet në internet është i besueshëm;

•Kuptoni që materialet që nuk janë të dedikuara për ju nuk duhet të shikohen nga mosha juaj;

•Mos jepni të dhëna personale;

•Bisedoni me prindërit tuaj për të identifikuar bashkarisht faqet dhe burimet serioze të informacionit;

•Mos shkarkoni dhe dërgoni foto dhe video me përmbajtje të dhunës seksuale ndaj fëmijëve apo kur ato janë të papërshtatshme (me përmbajtje të dhunës ekstreme, bullizmit, rrahjeve, vrasjes apo keqtrajtimit të fëmijëve apo edhe të kafshëve, apo materiale me sharje ose përmbajtje fyese e degraduese);

# SI TË MBROHEMI NGA CYBERBULLYING

- Mos iu përgjigj mesazheve cyberbullying;
- Ruani mesazhet në orën dhe datën që i keni marrë si dëshmi në rast raportimi. Ruaj Print Screen-et, e-maillet, tekstet e mesazheve;
- Blokoni aksesin e atyre personave me të cilët nuk dëshironi të komunikoni;
- Nëse keni pranuar mesazhe me përmbajtje fyese apo kërcënuese, nuk është faji juaj. Tregojuni menjëherë prindërve apo një të rrituri të besuar.
- Bisedoni me një të rritur, familjar, të afërm për ngacmimet që ke pasur. Ndhimojni prindërit tuaj të kuptojnë situatën dhe shqetësimet që ju po kaloni;
- Mundohuni ta identifikoni personin i cili ju ngacmon
- Mos u hakmerrni ndaj atyre që ju ngacmojnë;
- Kërkoni ndihmë. Bisedoje me mësuesin tënd, psikologun e shkollës etj;
- Heshtja, kur të tjerët janë duke u lënduar, nuk është e pranueshme. Nëse i lejoni në të vazhdojnë t'iu mendojnë, t'iu vënë në siklet cyberbullying nuk do të ndalet;
- Raportoni menjëherë në faqen [ëëë.isigurt.al](http://ëëë.isigurt.al)

# BËNI KUJDES!!!

- **Mos jepni informacion** rreth adresës së shtëpisë, shkollës apo numra telefoni personave të panjohur dhe/ose atyre të njohur nëpërmjet internetit;
- **Mos shkarkoni foto ose video** të dërguara nga adresa/persona të panjohur ose të njohur nëpërmjet internetit;
- **Mos dërgoni fotografitë tuaja personale ose intime** ndonjë të panjohuri. Nuk mund ta dini se si mund të përdoren ato prej tyre;
- **Tregojini menjëherë prindërve, familjarëve më të rritur, mësueses tuaj ose na shkruani ne chat i [www.crca.al](http://www.crca.al)**
  - nëse ndiheni të rrezikuar ose të frikësuar. Në varësi të rrezikut që mendoni se ju paraqitet, telefononi policinë në numrin 112;
- **Kujtoni se personi që ju mund të njihni në internet mund t'iu thotë se është moshatari juaj**, por në të vërtetë mund të jetë një i rritur i cili kërkon t'iu lëndojë;
- **Mos lini takim dhe mos u takoni me asnjë person** me të cilin jeni njohur nëpërmjet internetit;
- **Asnjëherë nuk e dini se kush qëndron në anën tjetër të kompjuterit!** Tregohuni të kujdesshëm!;
- **Bisedojeni me mësuesin tuaj dhe psikologun e shkollës;**
- **Raporto menjëherë** pranë [www.isigurt.al](http://www.isigurt.al)
- **Telefono ALO 116 111** – Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë për të raportuar çdo shqetësimin tuaj;

## Ku mund të raportojmë? Cilat janë ndihmat që na jepen?

### - **Platforma ISIGURT.AL**

Klikojmë faqen [www.isigurt.al](http://www.isigurt.al) - nga celulari ose tableta. Në faqen kryesore dallohen lehtësisht dy rubrika:

- **RAPORTO** FOTO E VIDEO SEKSULE TË FËMIJËVE, DHUNË, NGACMIME, BULLIZËM APO KËRCËNIME NË INTERNET - **RAPORTO** GJUHË URREJTJE NË INTERNET

### - **Linja e Këshillimit për fëmijë ALO 116-111**

Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë – ALO 116 është një shërbim falas këshillimi dhe referimi për fëmijët. Ky shërbim komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116111 – Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë dhe ALO 116000 – Linja Kombëtare për Fëmijët e Humbur.

### - **Policia**

Kontakto në nr 112 ose 129 për të kryer një denoncim, ose drejtohuni pranë komisariatit më të afërt apo pranë Drejtorisë së Policisë për shqetësimin tuaj

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!! 😊